



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1123/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Milena Đerić dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në rrjetin social Facebook, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa: Anr.1123/2021 e datës 14.11.2021, e paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në rrjetin social Facebook, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021.

A r s y e t i m

Me datë 14.11.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.1123/2021, të paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë kundër Ilir Ferati, kandidat për Kryetar të Komunës së Istogut nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se aktivistët e këtij subjekti me datën 14.11.2021 kanë vërejtur se kandidati për Kryetar Komune Ilir Ferati ka thyer heshtjen zgjedhore duke vazhduar sponzorizimin e postimeve me përmbajtje elektorale të cilat janë shfaqur në rrjetin social Facebook, dukë bërë thirrje që të votohet subjekti i tij politik. Si dëshmi ka bashkangjitur foton e marrë nga platforma e rrjetit social facebook.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik LDK e mohon se ka ndodhur shkelja e supozuar pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse pasi që nga fotot nuk mund të vërtetohet se reklamat janë publikuar apo kane vazhduar edhe në ditën e heshtjes zgjedhore pasi që me asnjë prove nuk është argumentuar data dhe ora e reklamave që pretendohet se janë publikuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale,, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, me datë 14.11.2021 ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e pabazuar ngase nuk ka qenë e mundur të vërtetohet në rrugë elektronike nëse e njëjta me datën 14 nëntor 2021 ka qenë aktive, pasi që në kohën e testimiut e njëjta ka qenë jo aktive.


Duke marrë parasysh të cekurat më lartë, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve për ankesat, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësi i supozuar me datë 14.11.2021, e ka vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në rrjetin social "Facebook", edhe në ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit.

Nga provat e ofruara nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklama e shkelësit të supozuar është publikuar apo ka vazhduar sponsorimi i fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit, edhe pse parashtuesi i ankesës ka paraqitur fotografi me të cilat pretendon se postimi i sponsorizuar ka qenë aktiv në ditën e votimit, paneli këto pretendime nuk mundi ti vërtetoj sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar ashtu siç pretendohet në ankesë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1123/2021 më datë 15.11.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.